



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Trupi Gjyqësor vendosi më 8 nëntor se Urdhri për Zhdëmtim do të shqiptohet të premten, më 29 nëntor, në orën 11:00, në seancë publike dhe në praninë e z. Shala. Tetë viktima morën pjesë në procesin e kësaj çështjeje gjyqësore. Ky do të jetë Urdhri i Dytë për Zhdëmtim që lëshohet në një çështje të krimeve të luftës, nga një Grup Gjyqësor i Dhomave të Specializuara.

Trupi Gjyqësor në këtë çështje gjyqësore, më 7 nëntor, miratoi kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për të lejuar ndryshim të pjesshëm të masave mbrojtëse lidhur me një viktimë pjesëmarrëse që është njëkohësisht edhe dëshmitar. Paneli konstatoi se nxjerrja e kërkuar e informacionit nuk do të përbënte rrezik për viktimën apo familjen e viktimit. Gjithashtu, Paneli mori parasysh se viktima kishte dhënë pëlqimin dhe se Prokuroria nuk kishte paraqitur kundërshtime.

Më 13 nëntor, Dhoma e Apelit, miratoi, pjesërisht, një kërkesë të Prokurorisë dhe Mbrojtësit të Viktimave dhe zgjati afatin e tyre për dorëzimin e përgjigjeve ndaj dosjes së apelit të z. Shala, deri më 17 janar 2025. Paneli e bazoi vendimin në faktin se ka numër të kufizuar personeli gjatë periudhës së pushimeve të Gjykatës. Z. Shala pritet të dorëzojë dosjen e tij të apelit deri më 25 nëntor 2024.

Fillimi i gjyqimit në çështjen gjyqësore të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës, i caktuar për më 14 nëntor, u shty nga Trupi Gjyqësor më 12 nëntor, me kërkesë të palëve.

Të akuzuarit akuzohen për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe frikësim gjatë procedurës penale.

Më 11 nëntor, Trupi Gjyqësor miratoi kërkesën e Prokurorisë për ndryshimin e listës së provave materiale dhe shtimin e gjashtë raporteve plotësuese nga instituti i jashtëm kriminalistik dhe të një shënimi lidhur me një videoincizim. Trupi Gjyqësor vlerësoi se raportet japin informacion të konsiderueshëm shtesë dhe se shënimi lidhur me materialin filmik do të ndihmojë palët, si dhe Trupin Gjyqësor për vlerësimin e videoincizimit.

Më 13 nëntor, Trupi Gjyqësor urdhëroi palët dhe Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, në Zyrën Administrative, të organizojnë një proces të informimit të dëshmitarëve në mënyrë që të njihen me sallën e gjyqit, të informohen për proceset dhe cilat janë palët e përfshira. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor kërkoi që dëshmitarëve t'u jepen deklaratat e tyre të mëparshme. Trupi Gjyqësor rrëzoi kërkesën e Prokurorisë për lejimin e takimeve përgatitore me dëshmitarët, mbi bazën se ngjarjet në fjalë kanë ndodhur në prill 2023 dhe





dëshmitarët e thirrur nga Prokuroria janë intervistuar kohët e fundit e për rrjedhojë ngjarjet i kanë të freskëta në mendje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses më 11 nëntor rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes që të lejohej të apelonte një vendim të Trupit Gjykses për pranimin e dëshmisë së gjashtë dëshmitarëve vetëm në formë të shkruar. Trupi Gjykses ishte i mendimit se pikat e ngritura nga Mbrojtja ishin thjesht mospajtim me vendimin e mëparshëm të Trupit Gjykses për pranimin e dëshmive në fjalë.

Më 13 nëntor, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për të lejuar ndryshimin e masave mbrojtëse lidhur me një viktimë pjesëmarrëse, për t'u dhënë informacion autoriteteve të caktuara. Trupi Gjykses konstatoi se nxjerrja e identitetit dhe statusit të viktimës për autoritetin përkatës nuk përbën rrezik për viktimën apo familjen e viktimës.

Më 13 nëntor, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit pasi konstatoi se ekzistojnë ende rreziqet që të akuzuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor dhe/ose të kryejnë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses gjykoi se, duke marrë parasysh se gjykimi është në zhvillim e sipër, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve të cënueshëm janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren, çka rrit rrezikun që informacioni i ndjeshëm të bëhet i njohur për publikun. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konstatoi se lirimi i një të akuzuari që ka informacion të tillë nuk do të ndihmonte për mbrojtjen e efikase të dëshmitarëve që ende nuk kanë dhënë dëshmi.

Sa i përket sjelljes së z. Selimi në objektin e paraburgimit, Trupi Gjykses rikujtoi konstatimin e vet se duket se z. Selimi u ka zbuluar informacion të mbrojtur palëve të treta, çka përforcoi konstatimin e Trupit Gjykses se lirimi i z. Selimi përbën rrezik për pengimin e ecurisë së procesit gjyqësor.

Deri tani, 103 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në gjykatë në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në çështjen Thaçi dhe të tjerët, është caktuar për të hënë, 18 nëntor, në orën 09:00 të mëngjesit.

Ndër lajme të tjera: Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Ekaterina Trendafilova, të martën u takua me përfaqësues të shoqërisë civile të Kosovës dhe gazetarë, përmes internetit. Gjatë këtyre aktiviteteve, ajo dha përditësime lidhur me ecurinë e çështjeve gjyqësore aktualisht para Gjykatës, si dhe iu përgjigj pyetjeve të tyre.

Gjatë bisedës me shoqërinë civile, Kryetare Trendafilova, ndër të tjera, u pyet lidhur me seancat gjyqësore që janë të mbyllura për publikun. Pasi theksoi rëndësinë e transparencës, ajo shpjegoi masat e ndryshme që marrin gjykatësit për të garantuar që proceset gjyqësore të jenë sa më publike që është e mundur dhe shtoi se, në rastet kur seancat janë të mbyllura për publikun, kjo bëhet për mbrojtjen e dëshmitarëve.

